



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:044275

Datë: 27.02.2025

Numri i dokumentit: 06914827

2022:044276

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.B. nga fsh...., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.280/22 të datës 03.03.2022, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor më datën 13.02.2025, në prani të Prokurorit të Shtetit Ardian Emimi, të dëmtuarit P.Z. dhe të akuzuarit dhe po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 27.02.2025, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari N.B., nga i ati Sh., e ëma F., e gjinisë B., i lindur më ... në fsh. ... Komuna Ferizaj, ku edhe tani jeton, me nr. personal, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, prind i katër fëmijëve, punëtor privat, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë për vepër tjetër penale vjedhje, ndaj tij zhvillohen edhe procedura tjera penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Më datë 08.02.2022 rreth orës 12:00, në fshatin Surqinë- Ferizaj, me dashje dhe me qëllim të frikësimit, seriozisht e kanos tani të dëmtuarin P.Z., se do t'a privoj nga jeta dhe atë pasi që ky i fundit e thërret në telefon me numër lidhur me një mosmarrëveshje që kishin pasur rreth një borxhi, ku i pandehuri i drejtohet me fjalët se *“në vendin ku ti del për të kullotur bakëtin, unë kam me të zan dhe ti ke hangër dhe, e nëse vini edhe njëherë kom me ju korrë automatik (kallash)”*, e krejt kjo për shkak se i dëmtuari ishte detyruar që disa herë të shkojë në shtëpinë e tij për t'i marrë paratë, ashtu që si rrjedhojë e fjalëve tek i njëjti ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe pasigurisë.

Me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 79 dhe 181 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neneve 364, 452 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të akuzuarin e:

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 350 € /treqind e pesëdhjetë euro/, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shëndrrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzetë Euro/, si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 /njëzet/ Euro, të gjitha brenda afatit prej 30 ditëve.

I dëmtuari P. Z. nga fsh.... K Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr.280/22 të datës 03.03.2022, ka ngarkuar të akuzuarin, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.2 të KPRK-së dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar për të akuzuarin gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës, me datë 13.02.2025, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit, i dëmtuari dhe i akuzuari.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tija në kuptim të nenin 319 par.1 dhe 2 të KPPRK-së dhe pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës dhe prokurori i shtetit para leximit të aktakuzës ka deklaruar se pas shqimit të videoinqizimit bëj plotësimin e aktakuzës, që në rreshtin e 5 të të dispozitivit ti shtohen edhe fjalët “në vendin ku ti del për të kullotur bagëtinë, unë kam me të zan dhe ti ki me hangër dhe, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar. Gjyqtari pasi që është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, konform nenit 321 paragrafi 1 të KPPRK-së, i ka afuar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, gjyqtari pas pranimit të fajësisë së të pandehurit, në kuptim të nenit 332 par. 2 të KPPRK-së, merret mendimi i prokurorit të shtetit dhe palës së dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë së të akuzuarit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit N.B. për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.2 të KPRK-së, pasi që një pranim i tillë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në përputhje të plot me dispozitat e nenit 242 lidhur me nenin 322 të KPPRK-se, mbështetet në provat dhe

faktet që i përmban aktakuza , andaj i propozoj gjykatës që të njëjtin ta pranoj dhe ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal sipas kodit penal në fuqi.

I dëmtuari deklaron se lidhur me pranimin e fajësisë së të akuzuarit deklaron, e kundërshtoj pranimin e fajësisë, i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe po ashtu do të paraqes kërkesë pasurore juridike.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë, deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit N.B., të dhënë para hetuesve policor, me dt.10.02.2022 , deklarata e të pandehurit N.B., e dhënë në Stacion Policor Ferizaj, e datës 11.02.2022, raporti fillestar dhe raporti i oficerit i përpiluar më dt.08.02.2021, CD-ja, si dhe shkresat tjera që janë pjesë e lëndës.

Pasi që Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është në përputhje me kërkesat nga neni 242 par. 2 KPPK-së, konform nenit 322 paragrafi 4 të KPPK-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.2 të KPRK-së, ngase nga provat materiale dhe personale po edhe nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit me pa mëdyshje u vërtetua gjendja faktike si në dispozitivin e aktakuzës. Andaj duke pasur parasysh të cekurat më lartë i propozoj gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet një sanksion penal sipas kodit penal për veprën penale për të cilën akuzohet. Me rastin e matjes të llojit dhe shqiptimit të dënimit të merret parasysh si rrethanë lehtësuese pranimi i fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese të merr parasysh cenimi i jetës së të dëmtuarit.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrahi në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit dhe mbes pranë asaj që deklarova më lartë se i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe po ashtu do të paraqes kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari në fjalën përfundimtare deklaroi se unë siç deklarova më lart e pranoj fajësinë, e di që kam gabuar dhe pretoj se në të ardhmen të njëjtin nuk do ta shqetësoj dhe do të mundohem të merrem vesh me të sa i përket borgjit për të cilin po thotë i dëmtuari.

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimin e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale për çka dhe i akuzuari u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari e ka bërë pranimin e fajësisë, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërit vepra të tilla apo të ngjashme, se prokuroria nuk ka afruar dëshmi dhe nga evidenca e gjykatës shihet se i njëjti para kryerjes së kësaj vepre penale të jetë dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, ndërsa rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë dhe se për herë të parë ka kryer vepër penale do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, e në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërisë dhe autoritet të tij, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale (preventiva gjenerale)

Vendimi për kërkesën pasurore- juridike, është marrur konform nenit 462 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par.
1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3 pika
3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2022:044276 , datë 27.02.2025**

Zyrtare ligjore
Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në
Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të
tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.